

Politika e cilësisë dhe mjedisit për “Forschner Group”

Ne jemi një kompani familiare e pavarur dhe jemi të përkushtuar ndaj vlerave dhe qëllimeve tona. Veprimet tona të përgjegjshme përcaktohen nga vendimmarrje të qëndrueshme në marrëdhëniet e brendshme dhe të jashtme

Orientimi ndaj klienteve:

Orientimi ynë ndaj klientëve ka për qëllim rritjen e kënaqësisë së tyre dhe bazohet në marrëdhënie të drejta dhe të qëndrueshme.

Ne deshirojme të jemi partneri kompetent për klientet tane dhe deshirojme të prezantojme rezultate të besueshme dhe të orientuara drejt zgjidhjes së problemeve.

Orientimi ndaj punonjësve:

Ne jemi të vetëdijshëm se punonjësit tanë janë çelësi i suksesit dhe ne jemi të përkushtuar për sfida, promovime dhe për të zhvilluar ata individualisht sa më shumë që të jetë e mundur.

Orientimi ndaj cilësisë:

Së bashku ne i kemi vendosur vetes qëllime për të arritur një rritje të kënaqësinë së klientit. Fokusi është në kërkesat e klientëve, të cilat ne duam t'i përmbushim në nivelin më të lartë përmes konformitetit të produktit dhe shërbimit (strategjia e defektit zero).

Orientimi ndaj mjedisit dhe sigurisë së produktit:

Duke marrë parasysh kërkesat aktuale standarde dhe ligjore, ne deshirojme të kursejmë burimet dhe të minimizojmë ndikimet negative në mjedis si dhe rreziqet në lidhje me sigurinë.

Orientimi ndaj qëndrueshmërisë:

Veprimet tona janë gjithmonë të drejtuara drejt qëndrueshmërisë. Për këtë qëllim, ne jemi të angazhuar për zbatimin e një koncepti qëndrueshmërie në mënyrë që të përmirësojmë efektivitetin dhe efikasitetin në fushat e ekologjisë dhe çështjeve sociale.

Përmirësimi i vazhdueshëm në të gjitha fushat:

Përmirësimi i vazhdueshëm është një angazhim i vazhdueshëm në të gjitha fushat, sistemet, proceset dhe produktet. Është shtytja dhe interesi ynë i vazhdueshëm, për të cilin të gjithë janë të përkushtuar.

Spaichingen, 01.08.2021



Peter Decker / CEO Forschner Group